# DËSHMI ARKIVI

**A-477499**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Haxhiu: Tensionet politike më shtynë të prisja para thirrjes së seancës |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/haxhiu-tensionet-politike-me-shtyne-te-prisja-para-thirrjes-se-seances/1031667/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 19:28:18 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 19:26:02 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d588826b765cd33da75a5ac3ce5229609ecbc0324a0c325c10c698e6e6f3779f` |
| TEKSTI | `84c670b0fd489c85a5f2317023e3e89130b4a5725e75527146ce400f78ce1db0` |
| PAMJA | `69c10aa98d2b0373a5f162cff8c8c4cde43039a7fce8b691069ee63baf860f17` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `63eee9295a07e230e9a20a2c7df35d5c17ae8fe7b212916bfaf99046c5151c57` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `1fd94ce259103b5d3a93736e630fca63414b31f94ba022dd5b4f87109ff485e9` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/63eee9295a07e230e9a20a2c7df35d5c17ae8fe7b212916bfaf99046c5151c57`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Haxhiu: Tensionet politike më shtynë të prisja para thirrjes së seancës



Kryetarja e Kuvendit të Kosovës dhe ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, ka deklaruar se vendimi për të mos e thirrur menjëherë seancën plenare për deklaratën mbi aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së është shoqëruar me kritika.

Duke folur në emisionin "Debat Plus", ajo shpjegoi se në atë periudhë si Kuvendi, ashtu edhe Qeveria, ishin kontestuar në Gjykatën Kushtetuese. Për këtë arsye, sipas saj, ishte e nevojshme të pritej derisa situata të qetësohej.

Haxhiu tha se për tri-katër ditë kishte pasur diskutime mes përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Ajo bëri të ditur se seanca u zhvillua sot, por filloi me më shumë se një orë vonesë, pasi deputetëve iu desh kohë të dakordoheshin për një draft të përbashkët. Sipas saj, dokumenti nuk pati asnjë votë kundër në Kuvendin e Kosovës.

Ajo e cilësoi miratimin e deklaratës si të rëndësishëm, pasi Kuvendi shprehu qëndrimin e tij dhe parashtroi disa kërkesa drejtuar institucioneve të Kosovës, të cilat, siç tha Haxhiu, po punojnë prej disa vitesh për këto çështje.

Haxhiu theksoi se më parë Kuvendi i Kosovës nuk kishte miratuar rezoluta apo deklarata që lidheshin me luftën dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë mbrojtjen e luftës dhe të popullit përmes UÇK-së. Ajo shtoi se janë miratuar disa rezoluta dhe deklarata.

Kryetarja e Kuvendit foli edhe për qëndrimin mbështetës të Shqipërisë pas vendimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Ajo tha se kishte qenë në komunikim me kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, Niko Peleshi, të cilin e kishte falënderuar personalisht për solidaritetin dhe përkrahjen ndaj Kosovës dhe familjarëve të personave që mbahen në Hagë e që, sipas saj, janë dënuar padrejtësisht.

Duke iu përgjigjur kritikave për vonesën, Haxhiu sqaroi se seanca plenare mund të thirret nga 40 deputetë

të fundit/


Haxhiu: Tensionet politike më shtynë të prisja para thirrjes së…


Tahiraj kritikon deklaratën për Specialen dhe kërkon…


A mund të ndryshohet ligji për Specialen dhe të falen të dënuarit?…


Roberto Carlos: 11 fëmijë, 7 gra, 3 Liga të Kampionëve dhe një…


Dita e 121 e protestës në Tiranë, qytetarët marshojnë drejt "Qyte…


Esposito shkruajnë historinë e Italisë, përsëritet një rekord…


Qendra "Gjenocidi në Kosovë – Plagë e hapur" mirëpret…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

përmes procedurës së seancës së jashtëzakonshme. Ajo tha se dy ditë pas vendimit, si Kuvendi, ashtu edhe Qeveria, ishin bërë objekt kontestimi.

Sipas Haxhiut, në atë kohë nuk kishte pasur kërkesa për thirrjen e seancës, ndërsa klima politike ishte rënduar nga gjuha kërcënuese ndaj deputetëve dhe ministrave. Për këtë arsye, ajo vlerësoi se ishte më e arsyeshme të uleshin tensionet, duke nënvizuar se kërcënimet, gjuha e urrejtjes dhe dhuna nuk i nevojiten vendit.

Shtuar më 28.09.2026 21:26

Tags: Albulena Haxhiu , kosova , Presidneti


Prishtina për të 13-ën natë radhazi në mbështetje të ish-drejtuesve të UÇK-së


Tahiraj kritikon deklaratën për Specialen dhe kërkon shpjegime nga LDK-ja pë…


A mund të ndryshohet ligji për Specialen dhe të falen të dënuarit? Përgjigjet ish…


Qendra “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e hapur” mirëpret qëndrimin e…


Haxhiu: Kuvendi duhej të shprehte qëndrimin për aktgjykimin e padrejtë


BE shqyrton afate për anëtarësimin e katër vendeve, ndërsa Kosova,…


Mbetjet mortore të dy personave identifikohen, nuk i përkasin “Grupit të…


Fetoshi: Fjalimi i Vuçiqit në OKB synoi t’i bëjë presion Perëndimit

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko


**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë


© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.